



UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” UNIVERSITY

Zija Shemsu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: E Drejta Sendore

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Sendore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i IV -të, semestri i VIII-të
Numri i orëve në javë:	3 +2
Vlera në kredi – ECTS:	8
Koha / lokacioni:	Ligjërata: (L); Salla:
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Sc Burim Tahiri
Detajet kontaktuese:	tahiri.burim@yahoo.com ,
Përshkrimi i lëndës	Problemet pronësore janë njëra ndër problemet më të ndërlikuara në Kosovë si në aspektin e drejtës, ashtu edhe në aspektin e të bërë biznes. Çdo transaksion biznesor në një mënyrë ose tjetrën ka të bëjë me atë që e quajmë “Pronësi ose Pasuri”, me përjashtim të rasteve kur objekt i transaksionit është ndonjë veprim (shërbim). Andaj, për çdo jurist që pritët të specializohet në fushën juridike civile, njohurit për të drejtën e pronësisë janë të domosdoshme. Kursi përfshinë shqyrtimin analitik të drejtës së pronësisë dhe të drejtave tjera sendore (Pronësisë, servituteve, hipotekës, pengut, të drejtës së ndërtimit dhe të barrëve sendore). Ky kurs do përqendrohet në shqyrtimin e çështjeve themelore të drejtës së pronësisë si kuptimin (përmbajtjen) e pronësisë, fitimin (krijimin) e pronësisë, transaksionet (bartjen) me të drejtën e pronësisë, kufizimet e të drejtës së pronësisë dhe shuarjen e të drejtës së pronësisë. Gjithashtu do të shqyrtohen edhe të drejtat tjera sendore sepse domosdoshmërisht janë të lidhura me të drejtën e pronësisë, ndërsa shqyrtimi për atë që është interesi i kursit që të drejtat pronësore të trajtohen në perspektivën e transaksioneve komerciale. Përmes këtij kursi synohet të merren njohurit themelore për të drejtën e pronësisë dhe të drejtat tjera sendore.

Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është ofrimi i njohurive ligjore dhe praktike për studentët në atë mënyrë se si të kuptohen më mirë 1) dispozitat ligjore me të cilat rregullohet e drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera sendore dhe 2) trajtimi profesional- Si dhe në çfarë mënyre pjesëmarrësit në transaksione të pronësisë, i plotësojnë nevojat dhe qëllimet e tyre, mund të negociojnë, të bartin të drejtat dhe detyrimet, marrjen ose bartjen e rrezikut në transaksione pronësore, avokimin dhe mbrojtjen e të drejtave pronësore dhe drejtave tjera sendore, rëndësia ekonomike e pronës dhe e drejtave tjera sendore etj. Përmes këtij kursi synohet që studentët të përgatiten me njohuri të nevojshme për zbatimin e tyre në praktikë.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të aftësohen për kryerjen e veprimeve si në vijim: - Të kuptoj nocionet dhe institutet e të drejtës së pronësisë dhe të drejtave tjera sendore si: servituteve, hipotekës, pengut, të drejtës së ndërtimit dhe barrëve sendore. - Të jenë në gjendje për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore nga fusha e të drejtës pronësore; - Të paraqes argumente verbale dhe me shkrim në çështjet e të drejtës së pronësisë në emër dhe për llogari të klientëve afarist - Të jenë në gjendje të kryen punë praktike në institucione të ndryshme të ndërlidhura me çështjet afariste: si gjykata komerciale, arbitrazhe, institucione financiare etj.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kolokviume	2	2	4
Detyra të shtëpisë dhe seminare	1	15	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	5	10
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	1	15	15
			179

Metodologjia e mësimit:	Ligjëratat do të ofrohen duke respektuar format e avancuara për mësimit. Do të zbatohet metodologjia e mësimit interaktive, e cila prezumon aktivitet si nga ana e mësimit është ashtu edhe të studentëve. Metodologjia e ligjërimit do të orientohet në krijimin e mundësive të studentët për të zotëruar dhe fituar njohuritë për të drejtën sendore. Do të pretendohet në shtjellimin e qartë e të saktë teorik të instituteve juridike në të drejtën sendore. Aspektet krahasuese nga të drejtat e vendeve të tjera do të ofrohen vetëm në rastet e nevojshme për të plotësuar zbrastitë teorike të së drejtës në Kosovë dhe për të avancuar njohuritë juridike. Interpretimi i ligjit nuk paraqet qëllim në vete. Shumë më tepër, përmes interpretimit ligjor pretendohet arritja e një konkluzioni. Deri te arritja e konkluzionit për një problem juridik do të duhej të respektohej skema e caktuar. Në këtë kuptim, studentët do të aftësohen që të jenë në gjendje për të krijuar opinionin juridik lidhur me një çështje dhe për të arritur tek një konkluzion, i cili ka bazën ligjore dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi. Theks të veçantë do t'i kushtohet aftësimin për analizë juridike në bazë të argumenteve që ndërlidhen me pronësinë.
Metodat e vlerësimit:	Punimi seminarik: 20 pikë Vijimi i rregullt dhe aktiviteti në sallë: 15 pikë Detyrat e shtëpisë 15 Provimi përfundimtar: 50 pikë <u>Totali: 100 pikë.</u> Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90 = 9; 91-100 = 10 Kalueshmëria e testit përfundimtar fillon nga 50 pikë e më lartë. <u>VËREJTJE:</u> Pikët shtesë të theksuara më sipër do të vlejnjë vetëm në rast kur studenti ka kaluar pozitivisht në provimin përfundimtar ose ka marrë rezultat pozitiv në dy kolokviume.
Literatura	
Literatura bazë:	Literatura që do të përdoret në lëndën E Drejta e Procedurës Civile është si në vijim: - Abdulla Aliu, “E Drejta Sendore (Pronësia)”, Prishtinë, 2014. - Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore.
Literatura shtesë:	Literaturë shtesë që do të përdoren por nuk obligohen: - Ejup Statovci, “Marrëdhëniet pronëso-ro-juridike në sendet e paluajtshme në KSA të Kosovës”. Prishtinë,

	1977, Ribotim 2009. - Ejup Statovci, “Pronësia, origjina dhe zhvillimi (studim komparativ)”. Prishtinë, 1983, Ribotim 2009. - Elizabeth Cook (eds.), “Modern Studies in Property Law”, Vol. 4, Oxford, 2007. - Haxhi Gashi, “Mbrojtja e pronësisë private në rastet e shpronësimit: analizë e legjislacionit pozitiv në Kosovë në raport me standardet ndërkombëtare – praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, Revista, E Drejta nr. 4, Prishtinë, 2009. - Francesco Galgano, “E drejta private 1 (pronësia)”, Luarasi, Tiranë, 2003.
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	- Prezantimi i lëndës, Hyrje, Qëllimi dhe Rëndësia
Java e dytë:	- Kuptimi i të drejtave sendore, në mënyrë të veçantë e drejta e pronësisë
Java e tretë:	- Bazat ligjore që rregullojnë të drejtat pronësore, - Parimet e të Drejtë Pronësore.
Java e katërt:	- Kuptimi dhe llojet e pronësisë
Java e pestë:	- Transaksionet me pronësinë, Fitimi, Humbja e pronësisë
Java e gjashtë:	- Vështrim i posaçëm i kontratave për shitblerjen e pronës. - Llojet e regjistrimit të të drejtave pronësore. - Regjistrimi i të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri.
Java e shtatë:	Testi i parë (I)
Java e tetë:	- E Drejta e servituteve, Nocioni, Parimet, Fitimi dhe Shuarja e Servituteve.
Java e nëntë:	- Llojet e Servituteve - Servitutet Sendore - Servitutet Personale
Java e dhjetë:	- Sigurimi i kërkesave të kreditorëve lidhur me pronën. - Llojet e mjeteve sigurorese lidhur me pronën.
Java e njëmbëdhjetë:	- Hipoteka dhe Pengu
Java e dymbëdhjetë:	- E Drejta e Ndërtimit. - Kuptimi juridik dhe specifikat e së drejtës së ndërtimit si e drejtë sendore.
Java e trembëdhjetë:	- Barrët sendore. - Përmbledhje e tërësisë së lëndës.
Java e katërmëdhjetë:	Testi i dytë (2)
Java e pesëmbëdhjetë:	Provimi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshme dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore, - Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore, - Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e kartelës në teste dhe provim, - Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet të përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësindhësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit